



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 28 mars 2019, në mbledhjen e XI-të (njëmbëdhjetë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.20’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fitim Haziri, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica dhe Floretë Zejnullahu, ndërsa mungoi Fatlume Jaha.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSH, Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, Donika Sfishta, drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit – DKRS, Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, Hamdi Jaha, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, dhe Gëzim Namani, drejtor i Drejtorisë së Administratës - DA

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues nga Rrjeti i OJQ-ve, Kujtim Hyseni dhe Rexhep Zeka.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit, i njoftoi rreth pikave të paraqitura në këtë rend të ditës dhe shtoi, kërkoj nga stafi teknik tek pika 5 në thirrjen e kësaj mbledhje, meqë plani përkatës është 4 vjeçar, viti 2022 të korrigjohet, të bëhet 2023.

Njëzëri u votua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit të dërguar, me korrigjimin e gabimit teknik në thirrjen e mbledhjes së Kuvendit, dhe atë në pikën 5 ku thuhet “2019 – 2022” korrigjohet, si vijon; “.....2019 – 2023”

1. Nisma e Kryetarit të Komunës për themelimin e bashkëpunimit ndër – komunal

- *Propozim vendimi për miratimin e Kërkesës – Nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal*
- *Propozim vendimi për Autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për themelimin e bashkëpunimit ndër – komunal*

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoj, ky propozim ka për qëllim bashkëpunimin ndërmjet katër komunave siç janë: Obiliqit, Prishtinës, Podujevës dhe Vushtrisë, përkatësisht aplikimin në grantin e Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal. Lidhur me këtë çështje materiali ju është dërguar dhe e posedoni, por vlen të theksohet se ky projekt është serioz dhe duhet të kemi parasysh që do të aplikojnë

edhe komuna tjera. Ne jemi në bashkëpunim me tri komuna tjera fqinje aplikuese në grantet në fjalë ku nëse jemi përfituese, Komuna jonë do të ishte përfituese e një projekti për një rrugë me asfaltim, trotuar dhe ndriçim dhe gjithë infrastrukturën përcjellëse, andaj apeloj tek të gjithë që ta përkrahim këtë kërkesë sepse koha e aplikimit është shumë e shkurtër, përkatësisht deri me 10.04.2019 dhe duhet të përfundojnë procedurat tjera që janë në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe ta përkrahim nesër në Kuvend.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së e përkrahim si propozim por dëshiroj të shtoj se ne si Komitet për Politik dhe Financa kemi kompetenca vetëm rekomanduese për pikat e rendit të ditës në Kuvend. Meqë Kryesuesi i Kuvendit pyeti, a jeni për rend të ditës, dhe po votohet komplet rendi i ditës, kërkoj edhe nga grupet tjera të Kuvendit që pasi po votohet komplet rendi i ditës mos të ndalemi te secila pikë specifikisht të debatojmë, përjashtimisht nëse kërkojmë nga ndonjë Drejtor i Drejtorisë të jepet ndonjë sqarim, përndryshe ne po e votojmë në fillim tërë rendin e ditës.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim

2. Informatë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për punët dhe aktivitetet gjatë vitit 2018

z.Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, dhe koordinator i KKS-së, e paraqiti informatën, ndër të tjera theksoi, unë nuk do të ju marrë kohë pasi që materialin e keni para vetes, mirëpo ju informoj se ne jemi munduar që maksimalisht të ofrojmë informacione lidhur me aktivitetet e KKS-së, në material gjeni fjalime bukur të gjata por jemi munduar që të përfshihen të gjitha në hollësi rreth gjendjes së sigurisë. Kjo informatë është votuar në mbledhjen e kaluar të KKS-së, andaj këtu jam për çka do që kërkohet.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim

3. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019 dhe destinim në kategori të caktuara buxhetore

Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, kjo është një pikë e rendit të ditës e cila pason nga mbledhja e mëparshme, nuk kam çfarë të shtoj më shumë sepse të gjitha sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme janë dhënë në mbledhjen e kaluar, mirëpo do të sugjeroja që ky propozim vendim të votohet në mënyrë që këto mjete të jenë në dispozicion për shfrytëzim për të mirë të qytetarëve të Podujevës. Vlen të theksohet se shuma e mjeteve buxhetore e propozuar është paksa e lartë, andaj nuk është mirë që këto mjete të mbeten të ngrira, por të shfrytëzohen në të mirë të qytetarëve.

z.Fitim Haziri, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së, i kemi vërejtjet tona ashtu sikurse në prezantimin e parë, por gjithsesi e rekomandojmë për kuvend dhe e diskutojmë.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim

4. Raporti financiar për vitin 2018

z.Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti raportin, ndër të tjera theksoi, të dhënat për përgatitjen e këtij raporti financiar për vitin 2018 është marrë nga Sistemi i Integruar i Ministrisë së Financave të Kosovës - SIMF, raport në të cilin janë përfshirë shpenzimet totale të buxhetit të ndara sipas kategorive publike, sipas programeve dhe sipas kodeve ekonomike duke bërë edhe një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Shpenzimet për vitin 2018 janë 18.791,690.00€, kurse të hyrat 1,262,405.00€. Meqë raporti është bukur i detajuar dhe ka material të mjaftueshëm, nuk do tju marrë kohë më shumë ngase të gjitha të dhënat veç janë në raport.

z.Avni Fetahu, theksoi, ne Grup i këshilltarëve të LDK-së e rekomandojmë si pikë për diskutim në Kuvend, dhe siç jemi dakorduar gjatë hartimit të planit të punës së Kuvendit, këto raporte të sillen më të detajuara dhe mundësisht numra me lapsa e me kimik mos të ketë për arsye se po i humb kuptimi raportit dhe po krijohet një përshtypje sikur po fshehët diçka, përndryshe raporti është voluminoz e që ka disa sugjerime që duhet të ketë një pamje më të mirë paksa sepse jemi asamble komunale dhe formati është shumë i vogël, s'mundet me u pa as me syza ndoshta, edhe pse ne gjatë hartimit të planit të punës së Kuvendit kemi kërkuar që raportet të sjellën më të pastërta në mënyrë që të mund të lexohen.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, theksoi, është një moshë e limituar për t'i mbajtur syzat për lexim, ajo moshë është mbi 40 vjeç dhe nuk është asgjë, pra kjo ishte vetëm sa për relaks.

z.Fitim Haziri, theksoi, po përcillen vërejtjet e njëjta çdo herë që na vinë raportet dhe një mungesë e transparencës për çështje të caktuara. Ky raport i buxhetit nuk është i detajuar, shembull kemi projekte të shkruara në grup, janë shtruar disa rrugë në një fshat dhe nuk ceket cilat rrugë janë shtruar, vazhdimisht janë të njëjtat vërejtje tek raportet e tilla. Mendoj se duhet të ceken rrugët secila veç e veç sepse tani të gjitha rrugët në komunën e Podujevës janë të emëruara prandaj pse të fshihen rrugët në të cilat janë kryer punimet, kjo është njëra ndër vërejtjet, kurse të tjera në seancën e nesërme do ti cekim.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, po bëhen 6 vite që vërejtjet i kemi të njëjta dhe në një formë nuk po e shoh të arsyeshme që në KPF të debatojmë për të njëjtat gjëra sepse po të ishim unanim ne, faktikisht siç than edhe parafolësit, raportet e tilla që sillen në kohen që jetojmë ne duhet do të duhej të jenë më shumë profesional. Mos të ketë sqarime të përgjithësuara, siç ceket vetëm fshati por të ceken rrugët në veçanti, andaj duke i eliminuar këto gjëra po i humb kuptimi edhe emrave të atyre rrugëve. Po ashtu edhe zyrtarëve komunal po t'ju thuash ku është kjo rrugë nuk e dinë e lëre më qytetarët. Edhe sa i përket rialokimit po i them Drejtorit se ka kohë me u përgatit deri nesër, të gjitha mjetet e rialokimit që ke vendos me i bartë nesër në seancë duhet me i përgatit ato mjete konkretisht, në rrugë, infrastrukturë publike apo në të gjitha dikasteret që i ke paraparë ato mjete duhet të tregosh në cilën rrugë, fazën e ndërtimit dhe duhet me pas përgjigjeje në këtë punë. Nëse vetë Drejtoria që i përgatit dokumentet nuk i din këto gjëra, unë personalisht nuk do të kisha qëndrim fare të hyja në Kuvend të më bëjë pyetje dikush për punët e mija dhe do matesha me ardhë ose jo në seancë, ngase ato mjete janë të prezantuara në lista të projekteve. Ne nuk jemi që ti bllokojmë proceset as të operatorëve ekonomik as punët që qytetarët i gëzojnë, por ne kërkojmë vetëm me qenë konkret, e jo vetëm të përmenden, shembull asfaltimi i rrugëve në Lupç dhe mos të ketë konkretizim, ose siç kemi rastet ku Drejtoria i shkruan me laps numrin, kjo është jo profesional. Nuk është problemi që na nevojiten syza që e ceku një Drejtor parafolës për të lexua sepse ne po e shohim çka shkruan aty, por problemi është që nuk ka përgjigjeje dokumenti e kur nuk ka përgjigjeje në dokument, duhet të bëhen pyetje në seancë e jo të bëjmë politikë ngase nuk jemi mbet shumë për politikë sepse kemi mbet si fshat. Unë e shikova sot, rruga “Zahir Pajaziti” sërish gërmihshin aty operatorët, vetëm heqin dhe qesin u bo pluhur, më parë miratohet një buxhet me u krye ato punë qysh duhet me u shtrua asfalti me u rregullua ndriçimi dhe me u mbyll ajo punë, dhe vetëm

urdhëroni paraqiteni projektin, bëjeni kërkesën dhe le të përfundoj sheshi “Zahir Pajaziti” e jo të bëhen gjëra çfarë po bëhen. Në këtë kontekst edhe projektet kur i bëni parashihni mjetet në tenderim, nuk e di kush e ka bërë planin as si kanë shkua procedurat e prokurimit por për punën që është bërë nuk besoj që është i kënaqur as Drejtori i DPUMM z.Hamdi Jaha sepse është qendra e qytetit, hyrja e Podujevës edhe kanë qenë mjetet buxhetore të ndara andaj është deshtë të kryhet puna. Unë jam i vetëdijshëm që me këtë buxhet s’mundemi me bo Podujevën të lulëzoj, mirëpo prej para fushate ja ka nisë kjo rrugë dhe nëse është çështja tek mjetet financiare këto mjete janë për ti shfrytëzuar. Mandej kemi shtrimi i rrugëve me zhavorr, për cilat rrugë është fjala, madje mendoj se në vitin 2019 nuk bën të shtrohen rrugë me zhavorr fare, më mirë është të asfaltohen 5 rrugë në Podujevë së bashku me infrastrukturën përcjellëse. rreth 90% Podujeva është e asfaltuar, disa nga nivelit qendror, disa nga niveli lokal, mirëpo mjetet buxhetore 6-7 milion sa janë, si dhe 1 milion euro nga të hyrat vetanake për investime kapitale, konkret të investohen në çdo lagje ka 2 milion, Podujeva shumë do të ndryshonte. Nuk e di ku kanë shkuar qe 1 - 2 vite 10 milion euro mjete financiare, pa i llogarit investitorët jashtë buxhetit, është një shumë e madhe dhe po i bie që janë futë 3 milion në sheshin “Zahir Pajaziti” e në fakt kjo rrugë është duke u degraduar. Ka kërkesa edhe nga shoqata e veterinarisë, për trajtimin e qeneve endacak por u mbet e bllokuar ajo çështje, unë e di që ju nuk jeni kompetent por është Kryetari i Komunës, paraqitet kërkesa për funksionalizim dhe trajtim të përbashkët me Agjensionin e Veterinarisë, por edhe tani e tutje fëmijët janë të rrezikuar. A din ndokush të më tregoj se prona ku qëndron qendra e veterinarisë, e kujt është, pse nuk lirohet ajo pronë por mbetet e uzurpuar, kush duhet ta liroj atë pronë. Një kërkesë e tillë që sillet në Komunë prej qytetarëve, duhet të trajtohet nga dikush, brenda sepse ne këshilltarët nuk jemi për t’ju kthyer përgjigjeje, mirëpo po ju japim mbështetje kompetentëve për me ndërmarr veprime për çfarëdo problemi. Nuk po kthen përgjigjeje askush, e di që ju ka blloku Kryetari se ai duhet me jap përgjigjeje, ashtu sikurse ndodh edhe në nivel qendrorë ku bllokohen ministrat për çështje të caktuara, kjo është evidente dhe jemi në dijeni në çfarë shoqërie jemi tu jetuar. Prandaj ju kisha lutë, ngase banaliteti ma i madh më duket kur dal në Kuvend dhe diskutoj për çështje teknike, apo të pyes cila rrugë është kjo ose ajo, kështu që përgatituni për nesër, orientimisht duhet zhbllokuar procesi sepse në seancën e kaluar nuk kaloj alokimi i mjeteve, unë e di që çdo vonesë shkon Komuna në dëm sepse janë edhe mjetet juridike sipas të cilave duhet të bëhen pagesat si dhe kamatën 8 %.

Edhe përgjigjja e Drejtorit të DSHMS-së i cili në mënyrë ironike i tha Avniut, është mosha me i bajt syzat, ato i përcakton mjeku e jo injoranca politike, ngase vërtetë janë shkronjat e vogla, unë s’po dua të hy në atë mes por po kërkoj përgjigjeje konkrete për pyetje përkatëse, e jo duhet ose jo me bartë syza, ngase këtu më gatishmëri ka opozita të përmirësoj organet qeverisëse që janë kompetente për kryerjen e punëve, se të tjerët.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësit, edhe ne takimet ku janë me serioziteti më të madh ku luhet roli i një shteti, ka pak humor, mos të merret si me qellim ndonjë gjë. Kur përmenda vënien e syzeve, unë e pata vetëm për relaks, andaj nuk do të doja të keqkuptohej ajo.

z.Mehmet Gashi, theksoi, unë vetëm nja dy pyetje pata. Raporti ka ardh me kohë edhe në aspektin ligjor sa i përket tri periudhave, janar-mars, janar-qershor edhe nëntor. Drejtori e ka bo raportin sipas të dhënave që i kanë ardh por thash mos është bërë ndonjë gabim teknik në faqen 7 të hyrat vetanake në vitin 2016 mos duhet me qenë 2017.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, përgjigje parafolësit, po është gabim teknik tregova që të dhënat janë marrë nga Sistemi - SIMF dhe kështu ishte e shkruar, por mund të përmirësohet, nuk ka ndonjë problem.

z.Mehmet Gashi, theksoi, edhe tek faqja e parafundit janë të hyrat vetanake 1,262,405.00 €, e tash në faqen e fundit janë të hyrat vjetore me një shifër tjetër, andaj mos është ndonjë gabim teknik ngase në muajin maj është 251,634.25€ e kur i mbledh këtu nuk del kjo shumë edhe totali nuk përputhet me këtë shumë prandaj nuk jam i qartë nëse ka mundësi të sqarohemi.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, përgjigje, në tabelën e parë janë të hyrat vetanake dhe të hyrat indirekte, ndërsa tabela e fundit i jep edhe të hyrat nga donatorët, nëse ka gabime ne e shikojmë por faqja numër 32 janë vetëm të hyrat vetanake të komunës që i përfshin edhe të hyrat indirekte ndërsa faqja 33 i ka të dhënat të secilit muaj duke i përfshi edhe donatorë.

z.Avni Fetahu, theksoi, unë po e marr si relaks çështjen e vënies së syzeve, por ne si këshilltarë të Kuvendit, kur të miratohet buxheti, që është e nevojshme i vëmë edhe syzat se ajo është shumë e rëndësishme për neve, kurse ju si Ekzekutiv që jeni duhet ti mbani tërë kohën syzat për me shpenzua buxhetin ashtu siç duhet, ma e rëndësishme është ju ti mbani syzat, ne edhe nëse i harrojmë ndonjëherë nuk është problem.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim

5. Propozim Plani i veprimit për transparencë për periudhën 2019 – 2023

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoj, shefi për informim ka qenë në takim në nivel të përgjithshëm për ta bërë një plan të zbatueshëm i cili është bërë në nivel të gjitha Komunave, nëse s'keni ndonjë gjë për të shtuar, e hedh në votim që t'i rekomandojmë për Kuvend.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

6. Raporti i punës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për punët dhe aktivitete e kryera gjatë vitit 2018

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, e paraqiti raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, është një raport voluminoz ku jemi munduar ti pasqyrojmë aktivitetet dhe punët që janë kryer, në material janë të gjitha ndoshta ka edhe diçka që ka mund të rrjedhë, përndryshe ky është një raport i punës që është përmbledh nga sektori i shëndetësisë në kuadër të mjekësisë familjare, Qendrës për punë sociale, andaj pres kontributin e juaj për ndonjë këshillë sugjerim në lidhje me punën që është bërë në vitin 2018.

z.Fitim Haziri, theksoi, si Grup i këshilltarëve të LVV-së do të donim të informohemi paksa edhe rreth objektit të ri të Spitalit, isha një natë dhe kishin filluar të amortizohen dyert dhe gjëra të tjera, ta dimë kush është pune kryesi sepse kemi informata se në atë objekt nuk janë kryer punës ashtu si duhet dhe siç kanë qenë të obliguara, ta dimë se çfarë është investuar në atë objekt, si ka ardh aq shpejt deri tek ajo gjendje te keqe. Këtu ose është bërë ndonjë hajni e madhe në material me cilësinë ma të dobët, presim informata.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësit, objekti i ri është objekt i Ministrisë së Shëndetësisë, ne jemi duke e shfrytëzuar përkohësisht me një leje të veçante deri sa ta bëjmë një objekt të ri, jemi duke e shfrytëzuar objektin ndoshta për disa çështje. Shqetësimet që i ceke ndoshta në detaje nuk e di, aty është organizuar edhe një kujdestari e mjekësisë familjare që funksionon prej mbrëmjes deri në mëngjes me qëllim që fluksin e emergjencës ta zvogëlojmë aty. Ai objekt është punuar në disa faza, dhe është ndërtuar nga të hyrat vetanake të Komunës, nëse nuk gabojmë kanë qenë 4 faza për ndërtimin e tij. Unë nuk jam në dijeni për ndonjë prishje, përndryshe aty punohet përkatësisht ofrohen shërbime shëndetësore.

z.Fitim Haziri, theksoi, Komuna e Podujevës ka ndarë mjetet, dhe tash ai objekt nuk ka shumë kohë që është lëshuar në funksion, por si duket paska kohë që nuk e paske vizituar i nderuar Drejtor, se mjafton të shkosh në hyrje, dyert që hapen kishin rënë, pastaj tualetet ishin në gjendje të tmerrshme, shko shiko, ne

kemi informata që punë kryesi edhe pllakat i ka vendos me çmime më të ulta me qëllim që të kursej për vete, andaj të bëhet një hulumtim, të shikohet një hulumtim.

z.Zaim Thaqi, Drejtor i DSHMS, përgjigje parafolësit, unë nuk e di që një pllakë, (po flas për afër 2000 m²) është shkoqitë prej dyshemesë. Unë e thash dhe po e përsërisë se fëmijët tanë, familjaret tanë dhe të gjithë qytetarët marrin shërbime në atë objekt dhe nuk do të doja që të jetë ashtu. Sistemi i shëndetësisë në Komunën tonë është më mirë se që ka qenë më parë, nuk është ashtu siç dëshirojmë por nëse krahasojmë ku kanë qenë duke ofruar shërbime më parë, kurse si dhe ku është tani, ka shumë ndryshime, nuk po them se është gjithçka siç ne dëshirojmë, por ne jemi të hapur për sugjerime dhe këshilla gjithsesi.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, unë vetëm po i them Drejtorit të DSHMS-së se nuk ka projekt që tenderohet e nuk ka menaxher të projektit të caktuar nga po ajo Drejtoria përkatëse, përgjegjësia ekskluzive bie mbi Drejtorin përkatës i cili e ngrit menaxherin apo mbikëqyrësin përkatës të një projekti, dhe llogaridhënia lypet prej menaxherit. Edhe në DSHMS-së menaxherin që e keni caktuar për të mbikëqyrë punën duhet ta pyetni a është krye puna si duhet. Këto punë janë minore të diskutohen dhe as që nuk dëshiroj ta degradoj procesin, por kur të dëshironi shkojmë i shikojmë punët që janë degraduar edhe nëpër rrugë edhe në shëndetësi. Për punën që janë kryer është problem paska sepse me 1 milion euro ndërton objekt të ri, kurse 700 mijë euro, shumë e madhe është kjo drejtor, duhet të jap përgjegjësi dikush.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim

7. Informatë për aktivitetet dhe gjendjen në Njësinë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, me kërkesën e këshilltarit z.Rafet Llapashtica në seancën që është mbajt në janar, e kam përgatit një informatë pak më të hollësishme lidhur me rastin e punëtorit por edhe rreth gjendjes së tanishme në shërbimin e njësisë së zjarrfikësve të cilën ne si Komunën e kemi nën menaxhim, konkretisht për punën e tyre që janë duke e bërë, por unë nuk jam zgjeruar shumë. Kryesisht jam orientuar në disa pika që kam menduar se janë më kryesore për të qenë informimi më i mirë rreth zëvendësimit për një punëtor që është bërë për një kohë të caktuar dhe jam bazuar në vendimet që i ka marrë personeli Masat që janë marrë nga personeli me dy vendimet një ndaj punëtorit dhe një ndaj shefit të njësisë, megjithatë kam konsideruar se nuk është çështje krejtësisht e mbyllur mund të kemi ende edhe gjykime të tjera. Ajo çfarë mund të them është se buxhet tjetër nuk është shpenzuar, por punëtorët e kanë kryer punën për kolegün e tyre kur ata kanë qenë të lirë dhe nuk ka pasur ndonjë pagesë jashtë shërbimit apo shërbim të dyfishtë, por si dukuri është jashtë ligjore, dhe më shumë ka qenë si një ndihmë mes kolegëve, por kohëzgjatja e tyre ka qenë e pa pranueshme. Mbi të gjitha kam mbajt takime me gjitha grupet e zjarrfikësve të cilët shfrytëzoj rastin ti falënderoj që gjatë kësaj periudhe sa nuk e kanë pas shefin kanë qenë në nivelin më të lartë të punës, posaçërisht këto dy ditë kur jemi në aksionin me FSK-n ku të gjithë ata punëtorë janë në nivelin më të lartë profesional. Pavarësisht disa problemeve që i kemi, niveli profesional ka qenë i lartë dhe është një njësi shumë e ndjeshme dhe duhet ta kemi çdo herë gatishmërinë e tyre. Informacione më të gjera keni para vetes në informatë andaj nuk po dëshiroj ta komentojmë secilën por shpresoj që megjithatë çështja duhet të trajtohet nga ana ligjore. Më vjen keq që njësia e zjarrfikësve nuk është trajtuar si duhet, jo krejtësisht me fajn e Komunës por nuk është trajtuar sinqerisht puna e tyre, puna e natës, puna jashtë orarit etj, ata vetëm këto ditë janë 24 orë në punë dhe pagesat për punë më të gjatë nuk janë bërë, jemi munduar që ti kompensojmë me ndonjë ditë pushimi gjatë sezonit dimëror kur kanë qenë më të lirë.

z.Avni Fetahu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së, këtë informatë e rekomandojmë për diskutime në Kuvend. E konsiderojmë se kjo i kontribuon edhe transparencës dhe është një shprehje e mirë sjellja e

informatave nga Drejtoritë, dhe është mirë që është sjell edhe specifikisht për një ngjarje të caktuar dhe për gjëra të tilla duhet të funksionoj ligji për shkeljet e mundeshe që janë bërë.

z.Fitim Haziri, theksoi, për fillim dua disa informata nga Drejtori perkatës, aty u cek që janë përgjegjësit komunale, përgjegjësitë e Ministrisë dhe përgjegjësia që është e Agjencisë. Dua të pyes vendimi për komandantin e zjarrfikëseve nga kush nxjerrët.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSh, përgjigje parafolësit, në vitin 2012 është nënshkruar Memorandumi ndërmjet Komunës dhe Agjencisë për Menaxhimin Emergjent – AME dhe që atëherë personeli dhe të gjitha kanë kaluar në AME, ne kemi telashe edhe për shpalljen e një konkursi për të pranuar një punëtor. Tani këto çështje pak a shumë janë të koklavitura sepse në 2012 AME i ka marr të gjitha përgjegjësitë. Sipas ligjit për zjarrfikësit, nga Komuna është kërkuar të merret me servisimin dhe shpenzimet e automjeteve por jo edhe me personelin. Në vitin 2012 është formuar komision për ti bartë të gjitha transferet e pjesëtarëve të shërbimit zjarrfikësve dhe shpëtimit nga Komuna në Ministrin e Punëve të Brendshme dhe në AME, do të thotë janë dorëzua të gjitha listat sepse ka qenë me Memorandum e paraparë, mirëpo AME për fatin e keq nuk është marrë shumë vetëm me personel dhe ka kërkuar nga Komuna ti mbuloj shpenzimet për karburant për automjete edhe vlerësimi i punëtorëve ka kaluar në AME.

z.Fitim Haziri, theksoi, do të thotë shef i zjarrfikëseve z.Milaim Ajvazi ka qenë i njëjti prej 2012, dhe tani nëse bën shkelje e drejtë e kujt është ta shkarkoj atë, e Komunës, e Ministrisë apo e Agjencisë, sikur që është për rastin konkret që ky e ka mbajt një punëtor që 3 vite radhazi duke marrë paga dhe duke e zëvendësuar atë me koleg të punës, mënyra si e ka mbajt është e jashtëligjshme e tash për ketë shkelje që ka bërë është formuar një komision, tash komisioni nga Komuna dhe në bazë të asaj çka kuptova unë komisioni ka marr vendim dhe i ka heq një pjesë të pagës 1/3 për dy muaj, që është pezullim prej pune dy muaj si pushim, dhe sërish është kthyer në atë pozitë që ka qenë, a është presion prej ndokujt që ti si Drejtor të mos merrni masa sipas ligjit, si dhe përse të mos e shkarkoni nga detyra atë person.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSh, përgjigje, unë si Drejtor nuk mundem të shkarkoj askënd, masa që i është shqiptuar është pezullimi, dhe nuk është vendimi i fundit.

z.Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, përgjigjet, masat disiplinore janë kështu, vërejtja verbale, vërejtja me shkrim, suspendimi dhe largimi nga puna. Vërejtjen verbale dhe vërejtjen me shkrim e bën eprori pastaj e ngrit procedurën disiplinore dhe komisioni disiplinor ka të drejt me largu nga puna. Pezullimi bëhet me të ardhura të cilat karakterizohen në dy grupe e para është me 50% për ata që janë mbajtës të familjes dhe 70% të pagës për ata që nuk janë mbajtës të familjes kjo është për afat të caktuar dhe brenda këtij afati komisioni disiplinor duhet të mblidhet edhe një her për ta vlerësuar a largohet nga puna apo kthehet në punë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, unë e kamë kërkuar këtë informatë dhe të dhënat i kamë pas të detajuara për rastin në fjalë, duke mos dashtë ta zgjasim më shumë këtë diskutim, Agjensioni i Pyjeve të Kosovës ka lidhshmëri me Komunën, Agjencia e Menaxhimit Emergjent ka lidhshmëri me Komunën, Memorandumet e Bashkëpunimit, me legjislacionin në fuqi, i kom shikua në detaje kompetencat e Drejtorisë dhe kompetencat e shefit të qendrës së zjarrfikësve në nivel të Kosovës. Pastaj kam shikuar në detaje edhe shkeljen ligjore të shefit të qendrës së zjarrfikësve në Podujevë, e kam shikua edhe moralin politik, që po të mos ngritej nga askush kjo çështje nuk do të ishte marr me këtë problem askush. Është e vërtetë që kompensim apo pagesë e dyfishtë nuk është bërë, është bërë pagës e njëfishtë, e kom shikuar që nuk është bërë as pagës e dyfishtë për punën e dyfishtë, mandej është e vërtetë që komisioni disiplinor e ka dhënë një verdikt të vetin, por tani po të ngritet ndokush dhe të hap edhe rast penal për rastin në fjalë si hap i dytë. Për të mos vepruar me këtë hapin e dytë që e ceka, Drejtoria bashkë me komisionin perkatës, do tju lutesha të ndërmerri masa, ndoshta jo ekstreme qysh në fillim por më të buta perkatësisht largim nga ai pozicion udhëheqës, jo largim nga puna ngase ne kemi kërkesa për rritje të numrit të stafit të kësaj Njësie, por i njëjti shef i tyre nuk mund të qëndroj ende ngase nuk punon qysh duhet, madje tash ka thënë që nuk kam dhënë leje unë por Drejtori i

DSHPMSH, e që nëse është e vërtetë, do të ishte skandal ende më i madh. Për rastin në fjalë informata është sjellë dhe unë kam kërkuar këtë informatë sepse e di që ke qenë krejt i njoftuar ti si Drejtor, madje edhe ke dhënë miratim që të ndodh një gjë e tillë, sipas informatave që kam unë. Kam kërkuar nga shefi i njësisë së zjarrfikësve informata dhe sipas asaj që më është thënë, ju Drejtor nuk jeni të interesuar të shkohet me tutje me këtë rast sepse mund të dal diçka edhe për ty si i përfshirë. Prandaj nëse nuk ndërmerret diçka, ne duhet të shkojmë edhe me hapin e dytë. Nuk është e vërtetë që Komuna nuk ka kompetenca shumë sa u përket zjarrfikëseve, ka kompetenca edhe për rritjen e koeficientit e që zjarrfikësit në Komunën e Podujevës janë me pagesën më të ulët në nivel të Kosovës. Ne kërkomë të punohet vetëm në bazë të kompetencave, i shefit duhet ti themi të punoj vetëm si zjarrfikës sepse aty kemi me bollëk djem të ri me shkollë/kualifikim më të lartë dhe shumë punëtor, andaj Drejtoria duhet ta kryej punën e vetë. E kam shikuar dhe e kam trajtuar shumë çështjen e zjarrfikëseve deri aty sa që ka informata, por deri të konstatohet, që një pjesë e objektit është në pronë private, çështje që do të shikojmë me Drejtorin e Drejtorisë përkatëse z.Abaz Llugaliu a është e vërtetë apo jo, por nuk them që është pa qenë i sigurt. Unë të falënderoj që e ke sjell informatën ashtu sikurse edhe DSHMS-së, e që është hera e parë që është sjell ndonjë raport për DSHMS-në, gjë që s'ka ndodh më parë. Pra kur është puna e mirë unë e them.

Unë së bashku me bashkëpunëtor duke përfshirë edhe znj.Floretë Zejnullahu që është këtu prezentë, kamë qenë/vizituar njësinë e zjarrfikësve natën e vitit të ri, dhe shfrytëzoj rastin t'i falënderoj shumë për mikpritjen, pa marr parasysh bindjet politike, gjithçka ka qenë shumë mirë.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSH, përgjigje parafolësit, unë jam në gjendje të ballafaqohem me të gjithë punëtorët pa marr parasysh bindjen politike. Për rastin në fjalë jam ndje shumë keq për raportin e tyre edhe kur kam shkuar e kam parë i kam thënë edhe shefit që duhet ti rregullojnë raportet e tyre.

Gjithashtu kam përgjegjësi morale dhe nuk bie pre e ndonjë shantazhi, dhe po ju garantoj që në jetën time, 20 vite politik, nuk kamë marrë ndonjë shantazh dhe jam shumë i bindur se edhe informimin s'ma kanë bërë të drejtë dhe e kanë keqpërdor besimin, por si temë është e hapur dhe do të vazhdojmë me procedurat tjera, gjithsesi shërbimi i zjarrfikësve është në formë të lartë dhe ndihem krenar që kemi një shërbim të tillë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoj, unë personalisht për të vetmen çështje që ndihem krenar më së shumti në veprimtarin time, është që jam iniciator i themelimit të Njësisë së Shpëtimit dhe Zjarrfikësve. Kjo ngase kanë qenë kërkesa të shumë komunave për themelimin e një njësie të tillë, por duke falënderuar edhe donacionet e Tirolit Austriak, kanë ardhë edhe huazime nga UNMIK-u dhe nga qendra, dhe është njëri prej shërbimeve më i sfiduar dhe me numrin më të vogël të stafit. Gjërat që u ceken kanë rrjedhë siç kanë rrjedhë, por do t'ju lutesha të gjithëve që të kemi kujdes në unifikimin dhe unitetin sepse janë njerëzit e parë që atakohen me shpëtimin e jetëve dhe shumë e shumë rreziqe tjera.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr.01-060/03-0027465/19
Podujevë,
28 mars 2019

Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi